



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:269294
Datë: 22.02.2023
Numri i dokumentit: 03999587

A.nr.61/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit A.. A.. nga V.., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.. A.., avokat nga R.., kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, për shkak të anulimit të vendimit 03/2227/17 të datës 15.12.2017, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 20.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit A.. A.. nga V.., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.. A.., avokat nga R....
- II. ANULOHET Aktvendimi 03/2227/17 i datës 15.12.2017 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 15.01.2018 ka kërkuar nga Gjykata anulimin e vendimit të kundërshtuar me padi. Pohon se anulimin e vendimit të atakuar e kërkon për shkak të vërtetimit jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Shton se Gjykata Themelore në Viti me aktvendimin nr.133/96 të datës 11.11.1996 e ka vërtetuar se e drejta e pronësisë mbi banesën në fjalë i takon paditësit dhe se kjo tashmë është një e drejtë e fituar e që është e drejtë më e vjetër se e drejta e cila pretendohet se ka fituar M.. S.. e më pas E.. H.. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin aprovohet si e bazuar padia dhe anulohet vendimi i kundërshtuar me padi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë , njoftojmë gjykatën se paditësi në bazë të vendimit të ligjshëm të gjykatës me numër 133/96 i dt.11.11.1996, e ka fituar të drejtën e pronësisë në banesën e cila gjendet në Viti në bazë të këtij akti ligjorë e ka parashtruar kërkesën AKK për regjistrim të pronës. paraprkasht paditësi me qelli të vërtetimit të drejtës së tijë subjektive i është drejtuar HABITATIT përkatësisht komisionit për çështje banesore dhe në bazë të vendimit HPPCC/REC /95/2007, e ka vërtetuar të drejtën e tij subjektive në lidhje me banesën në Viti e cila gjendet në rr.2 Adem Jashari2 në ngastrën kadastrale nr. 2057-1-10-2-9 me sipërfaqe prej 59m2. Duke u bazuar në vendimet e lartpërmendura paditësi i është drejtuar AKK-së, për regjistrim të së drejtës pronësore , megjithatë sëpari zyra kadastrale e Komunës së Vitisë e ka refuzuar kërkesën e paditësit ndaj të cilit vendim paditësi ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të të paditurës nr. 03/2227/17 e dt. 15.12.2017, me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e paditësit . Paditësi i pakënaqur me vendimi i organit të shkallës së dytë i njëjti parashtron padi për anulim të vendimit të shkallës së dytë për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe ligjeve numër 2002/5, 2003/13 dhe 04/L-009, me kërkesë që gjykata pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe anulohet vendimi i AKK-së, NR.03/2227/17 DT. 15.12.2017, me urdhërin që të aprovohet kërkesa e paditësit për regjistrimin e banesës si në referatin e padisë. Përgjigjen në padi të të paditurës e kundërshtoj sepse e njëjta është riprodhim i vendimit të ankimuar”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Pas administrimit të provave paditësi konsideron se është dëshmuar baza e pretendimeve të cekura të tij dhe kërkesëpadija e paditësit ka bazë juridikë , përkatësisht që organi i shkallës së dytë i padituri AKK, ka marr vendim jo të ligjshëm me të ciline ka refuzuar ankesën paditësit për regjistrim të së drejtës pronësore sepse siç kemi cekur paditësi kërkesën për regjistrim të së drejtës së pronës e bazon në dispozitat e ligjit për themelim e regjistrimit të paluajtshme rivë dhe atë neni 4 të ligjit të lartpërmendur , si dhe ligjet e mëparshme të cilat e kanë rregulluar këtë fuqi e të cilat i kemi cekur në padi. Gjykatës i propozoi që padinë paditësit ta aprovoi si të bazuar dhe të anuloi vendimin AKK NR.03/2227/17 DT. 15.12.2017, dhe ti urdhëroi AKK-në të aprovoi kërkesën e paditësit për banesën prej 59 m2, e cila gjendet në rr Adem Jashari p.n, nën ngastrën nr. 2057-1-10-2-1 Komuna e Vitisë”.*

E paditura me përgjigjen në padi të datës 24.10.2022 e ka mohuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se pala ankuese nuk ka ofruar ndonjë provë shtesë e cila do të na bindte që të nxjerrim vendim tjetër i cili do të rezultonte ndryshe nga ai i organit të shkallës së parë. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin e refuzon padinë si të pabazuar dhe e vërteton aktvendimin e AKK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë vendimit numër 03/2227/17 dt.15.12.2017, shkresa e dt. 25.07.2016, vendimi i dt. 15.10.1997, njoftimi i dt. 20.11.2017, kërkesa për regjistrim të paluajtshmërisë nr. 805/2015 e dt. 07.12.2015, kërkesa e dt. 17.08.2017, shkresa nga Gjykata Themelore në Gjilan Dega Viti e dt. 20.11.2017, përgjigje e kësaj gjykate me datë të njëjtë , njoftimi i dt. 03.11.2015, shkresa nga Agjencia Kosovare e Pronës e dt. 07.04.2017, aktvendimi i Komunës së Vitisë i dt. 07.07.2016, certifikata për njësinë kadastra le me numër 1-9888 ed t.07.12.2015, certifikata e lindjes së paditësit me datë të lëshimit 07.12.2015, urdhëri nga HPCC i dt. 17.10.2003, vendimi i Gjykatës Komunale në Viti me numër 113/96 i dt. 11.11.1996, kontrata për shitblerje të

paluajtshmërisë në gjuhën serbe e dt. 24.06.2004, Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Viti numër 26/2004 i dt. 29.04.2004, fletëpagesa bankare fotokopje e dt. 31.10.2011, certifikata e pronësisë P-70101007-02057-2 dt. 28.09.2011, shpallja publike me numër 433/2011 e dt. 03.11.2011- si datë e shpalljes, regjistrimi i kontratave për shitje të pronave banuese dt. 29.09.2003, kërkesa për plotësim të lëndës dt. 30.10.2017, ankesa e dt. 28.04.2017, urgjenca e dt. 14.08.2017. Pala paditëse e kundërshton provën-aktvendimi i Komunës së Vitisë i dt. 07.07.2016, Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Viti numër 26/2004 i dt. 29.04.2004 si dhe regjistrimi i kontratave për shitje të pronave banuese dt. 29.09.2003, dhe i njëjti nuk kishte propozime për prova të reja..

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij dhe gjeti se padia është e bazuar.

Gjykata gjeti se vendimi i të paditurës është i përfshirë në shkelje të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative për shkak se i njëjti nuk ka trajtuar në mënyrë të qartë të gjitha pretendimet ankimore të paditësit dhe bazën ligjore mbi të cilën janë ndërtuar pretendimet e paditësit për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, e paditura nuk ka zbatuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë nenin 48 të LPPA-së në të cilin thuhet:

“Neni 48-Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim

1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Gjykata shqyrtoi me kujdes përgjigjen në padi të të paditurës dhe për të njëjtën konstatoi se nuk mbështetet në asnjë provë të vetme dhe në asnjë argument ligjor e faktik. Përgjigja në padi përmban të dhëna të përgjithësuara dhe të paargumentuara duke mos përcaktuar rrugën e qartë ligjore të cilën është dashur ta ndjek paditësi me qëllim të realizimit të kërkesës së tij. Poashtu mungon arsyetimi në bazë të nenit 134, paragrafi 1 i LPPA-së sa i përket vlerësimit të pretendimeve të paditësit mbi atë se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë para individëve të cilët pretendohet të jenë pronar të paluajtshmërisë në fjalë.

Gjykata poashtu gjeti se si organi i shkallës së parë, ashtu edhe organi i shkallës së dytë të administratës, nuk ka marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura nga ana e paditësit.

Organi i paditur, gjatë riprocedimit, e konform nenit 132 të LPPA-së, duhet të ketë parasysh të gjithë dokumentacinin e paraqitur nga pala dhe të marrë parasysh veçanërisht, dokumentet ligjore përkatësisht vendimet e Gjykatave dhe Institucioneve tjera të ngarkuara me trajtimin e problemeve me prona. Organi i shkallës së dytë duhet të analizoj me kujdes të gjitha provat

materiale të cilat i posedon, ndërkaq të kërkoj nga paditësi dokumentacione shtesë nëse kjo do të shihet si e nevojshme dhe e domosdoshme që të vendoset në mënyrë të drejtë dhe duke mos anashkaluar të drejtat themelore të paditësit të garantuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Organi i paditur duhet të trajtoj qartë dhe në mënyrën e duhur të gjitha provat materiale, të cilat sipas palës paditëse mbështesin kërkesën e tij për regjistrimin e paluajtshmërisë dhe pastaj të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj e në gjendjen e vërtetuar faktike. Organi i paditur duhet të kujdeset që mosnjohuria e palës në procedurë administrative të mos jetë pengesë për njohjen e së drejtës të cilën pretendon se i takon.

Organi i paditur obligohet që të zbatoj nenin 95 të LPPA-së, duke i dhënë mundësinë ligjore të garantuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht duke e dëgjuar palën paditëse dhe duke kërkuar sqarime e dokumente shtesë të cilat do të ishin të rëndësishme në marrjen e një vendimi meritior.

Organi i paditur duhet të kujdeset që gjatë gjithë rrjedhës së procedurës, të veproj në përputhje të plotë me nenin 132 të LPPA-së. Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike është shkelur ligji në dëm të paditësit, andaj organi i paditur do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa e paditësit.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46, paragrafit 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.61/18, datë: 20.02.2023

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:269294
Datë: 22.02.2023
Numri i dokumentit: 03999587